



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____

“PËR

**TARIFAT PËR TË GJITHA VEPRIMTARITË QË ZHVILLOHEN NË
SEKTORIN E PYJEVE, MËNYRA DHE PROCEDURA E MBLLEDHJES SË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës e të nenit 13, pika 4, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Tarifat e veprimtarive që zhvillohen në sektorin e pyjeve janë të përcaktuara në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, për veprimtaritë e mëposhtme:
 - a) për dhënien në përdorim të fondit pyjor, sipas shtojcës nr. 1 të vendimit;
 - b) për heqjen nga fondi pyjor kombëtar sipas pikës 4;
 - c) për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar, sipas shtojcës nr. 2 të vendimit;
 - ç) për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore dhe për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore janë sipas shtojcës nr.3
2. Tarifat për dhënien në përdorim të fondit pyjor paguhet çdo vit, nga subjektet që marrin në përdorim fondin pyjor, pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës së qerasë për dhënien në përdorim të këtij fondi, të lidhur midis bashkisë në territorin e së cilës kryhet aktiviteti dhe subjektit fizik apo juridik që kryen aktivitetin.
3. Tarifa vjetore e përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 30 ditëve nga dita e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën muaj për vitet në vijim.
4. Tarifat për sipërfaqen e shfrytëzuar për heqjen nga fondi pyjor kombëtar përcaktohen në raportin tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore që hiqet, të hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 10 ditëve nga miratimi i aktit të heqjes nga fondi pyjor, njofton subjektin për kryerjen e pagesës së tarifës.
5. Tarifa e përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 10 ditëve nga dita e njoftimit. Moskryerja e pagesës brenda afatit të përcaktuar përbën kusht për anulimin e aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyjor.

6. Tarifat që paguhen për shfrytëzimin e fondit pyjor kombëtar për vendosjen e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të lëvizshme janë ditore, bazuar në kontratat sezonale të shfrytëzimit dhe paguhen në momentin e lidhjes së kontratës, në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.
7. Tarifat që paguhen për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor, derdhen në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse dhe mbledhja e tyre apo ekzekutimi i detyrueshëm, bëhet sipas procedurës të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
8. Tarifat për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore dhe për grumbullimin dhe nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jo pyjore paguhen pas shpalljes së fituesit në procedurat e konkurrimit publik dhe lidhjes së kontratës, në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.
9. Kur veprimtaritë e mësipërme zhvillohen në fondin pyjor privat mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifës përkatëse përcaktohet në marrëveshjen midis pronarit privat dhe subjektit të interesuara.
10. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore dhe Agjencia Kombëtare e Pyjeve.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi RAMA